MIRATOI

KRYETARI

Z. ARTUR BUSHI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KRUJE

OBJEKTI: "PUNIME PER REHABILITIMIN E SHKARKUESIT, REZERVUARI VERJON"

# RAPORTI TEKNIK

PERGATITI:

"ENGINEERING CONSULTING GROUP" SHPK

TIRANE 2022

## *Permbajtja*

*1. TE PERGJITHSHME ..... 3*
*1.1 Pershkrimi i zones se projektit ..... 3*
*1.2 Klima ..... 4*
*1.3 Ekonomia ..... 5*
*1.4 Vendndodhja e objektit ..... 5*
*1.5 Gjendja ekzistuese, Mbulimi i tokes dhe qellimi i saj ..... 7*
*2. QELLIMI I PROJEKTIT ..... 13*
*3. ZGJIDHJA TEKNIKE ..... 13*
*3.1 Rrymeshpejtuesi ..... 13*
*3.2 Pusi shuarjes se energjise ..... 14*
*3.3 Vepra ..... 15*
*3.4 Profili gjatesor dhe profilat terthore ..... 16*

# 1. TE PERGJITHSHME

## 1.1 Pershkrimi i zones se projektit

Zona e marre ne studim ndodhet ne fshatin Verjon, pjese e njesise administrative Nikel, Bashkia Kruje.

Kjo njesi administrative ka rreth 10.499 banorë, dhe gjendet afër qytetit të lashtë të Krujës, Tiranes e Vores.

Gjeografikisht Rinasi, Shtrihet 22 km veri – perendim te Tiranes.

Pozicioni gjeografik eshte i rendesishem pasi sherben si nyje lidhese te Veriut dhe Lindjes se Shqiperise me Tiranen dhe Durresin, e jugun e vendit. Gjithashtu ka nje rendesi te vecante per Shqiperine, pasi aty prane ndodhet Aeroporti Nderkombetar "TIA".

Persa i perket tokes, ajo eshte shume pjellore, sidomos per drithera dhe zarzavate, por nuk perjashtohen edhe llojet e tjera te te mbjellave, sic jane pemet frutore, vreshtaria, etj.




*Figura 1: Harta e Qarkut Durrës*

## 1.2 Klima

Klima e zonës së projektit sipas klasifikimit klimaterik hyn në zonën me klimë mesdhetare, me dimër butë e të lagësht dhe me verë të nxehtë dhe të thatë. Reshjet janë kryesisht në formën e shiut. Në Fushe-Kruje janë vlerësuar që ka mbi 250 ditë me diell gjatë një viti.

- Temperatura e ajrit:

Fushe- Kruja ka një klimë të ngrohte (temperatura mesatare vjetore 13-15 °C), vera është mjaft e nxehtë (temperatura mesatare e korrikut, 29 °C deri ne 42 °C píku në periudhën korrik–gusht).

- Reshjet e zones:

Mesatarja vjetore e reshjeve është rreth 1236 mm. Reshjet janë kryesisht në formën e shiut dhe të përqëndruara në gjysmën e dytë të vjeshtës, dhe dimrit.

- Era:

Era fryn, përgjithësisht nga dy drejtime, gjatë periudhës së ftohtë mbizotëron juglindja pa përjashtuar veriun. Në periudhën e ngrohtë të vitit kudo mbizotëron veriperëndimi. Sipas vrojtimeve që janë bërë në vendin tonë shpejtësitë konsiderohen mesatare në këtë zonë kodrinoro - fushore.

- Kushtet hidrologjike:

Terreni në këtë zonë bën të mundur që gjatë shirave të kemi rrëke të madhësisë së mesme dhe deri diku te medha.

| Month | Jan | Feb | Mar | Apr | May | Jun | Jul | Aug | Sep | Oct | Nov | Dec | Year |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Average high °C (°F) | 10.1<br>-50.2 | 11.6<br>-52.9 | 14.5<br>-58.1 | 18.2<br>-64.8 | 22.9<br>-73.2 | 27.1<br>-80.8 | 29.4<br>-84.9 | 29.3<br>-84.7 | 25.8<br>-78.4 | 20.5<br>-68.9 | 15.5<br>-59.9 | 11.6<br>-52.9 | 19.7<br>-67.5 |
| Daily mean °C (°F) | 6.7<br>-44.1 | 8<br>-46.4 | 10.3<br>-50.5 | 13.7<br>-56.7 | 18<br>-64.4 | 22.1<br>-71.8 | 24.1<br>-75.4 | 23.9<br>-75 | 20.6<br>-69.1 | 16<br>-60.8 | 11.8<br>-53.2 | 8.2<br>-46.8 | 15.3<br>-59.5 |
| Average low °C (°F) | 3.3<br>-37.9 | 4.5<br>-40.1 | 6.1<br>-43 | 9.2<br>-48.6 | 13.2<br>-55.8 | 17.1<br>-62.8 | 18.9<br>-66 | 18.6<br>-65.5 | 15.5<br>-59.9 | 11.6<br>-52.9 | 8.2<br>-46.8 | 4.9<br>-40.8 | 10.9<br>-51.7 |
| Average precipitation mm (inches) | 150<br>-5.9 | 135<br>-5.3 | 114<br>-4.5 | 97<br>-3.8 | 83<br>-3.3 | 55<br>-2.2 | 33<br>-1.3 | 42<br>-1.7 | 78<br>-3.1 | 116<br>-4.6 | 172<br>-6.8 | 161<br>-6.3 | 1,236<br>-48.8 |

- Diellezimi:

Nje nga elementet baze qe karakterizon klimen e nje zone eshte regjimi i diellzimit qe shprehet nepermjet numrit te diteve te kthjellta dhe atyre te vraneta. Per zonen ne studim, numri i diteve te kthjellta luhatet nga 6-7 dite ne muajt e dimrit dhe 16-19 dite ne muajt e veres. Per ditet e vraneta situata paraqitet ne kahe te kundert dhe konkretisht mesatarisht gjate vitit vrojtohen rreth 1-2 dite te vraneta ne kohen e veres dhe 10-12 dite te tilla ne kohen e dimrit. Nje parameter tjeter qe karakterizon rregjimin e diellzimit eshte rrezatimi i pergjithshem diellor qe shpreh energjine diellore e shprehur ne kalori per njesi te siperfaqes kal/cm2. Per hapesiren Tirane Durres ky lloj parametri matet vetem ne vendmatjen e Tiranes dhe ne baze te te dhenave rezulton se vlerat mujore te rrezatimit te pergjithshem luhaten nga 135.6kal/cm2 ne muajin dhjetor deri 570 kal/cm2 ne muajin korrik. Keto shifra tregojne nje potencial te konsiderueshem energjie diellore ne zonen ne studim, gje qe presupozon kushte shume te favor shme per zhvillimin ekonomik te kesaj zone.

### 1.3 Ekonomia

Fushe Kruja renditet ne zonat me nje zhvillim te mire ekonomik, te vendit. Kjo sepse gjendet ne zonen Tirane – Durres – Kruje qe ne tereso ka luajtur historikisht nje rol shume te rendesishem ne zhvillimin ekonomik te krejt vendit.

Ne kete zone jane te mundshme per t’u zhvilluar te gjitha aktivitetet ekonomike.

### 1.4 Vendndodhja e objektit

Kjo zonë përfshihet në pjesen qendrore të vendit tonë. Relievi është gati tërësisht fushor, disniveli i zones nuk i kapercen 5 m. Kuotat variojne nga 65 m mbi nivelin e detit deri ne 140 m mbi nivelin e detit.

ENGINEERING CONSULTING GROUP







*Figura 2: Ortofoto e zones se marre ne studim*

### 1.5 Gjendja ekzistuese, Mbulimi i tokes dhe qellimi i saj

Zona ne afersi te rezervuarit te Verjonit eshte ne pergjithesi e mbulur nga barishte. Zona vleresohet si toke e llojit are ku sot nuk eshte e shfrytezuar ose eshte e shfrytezuar pak per qellime bujqesore apo blektorale.

Persa i perket Shkarkuesit te Rezervuarit, ai ndodhet ne gjendje te mjerueshme. Strukturat prej betoni jane te degraduara, shpesh jashte funksionit.

Kanali transportues eshte ne gjendje akoma me te keqe, shtrati dhe skarpatat e tij jane te demtuara. Te carat kane permasa te tilla qe kane eroduar gjithe zonen. Si pasoje e ketij procesi, rezulton qe rryma e ujit ka nderruar rrjedhe, duke mos kaluar me ne kanalin e ndertuar enkas per transportin e ujit, por ka devijuar ne pjesen jug-lindore. Uji vershon ne tatepjete i pakontrolluar, levizja e tij ka gerryer themelet e mureve te pusit te shuarjes te energjise, i cili ka dale teresisht jashte funksioni.

Pusi i shuarjes se energjise ka patur te njejtin fat, muret e tij jane te demtuar, madje ne pjesen e fundit muri eshte i shkaterruar i gjithi.








**ENGINEERING CONSULTING GROUP**
HEAD OFFICE - TIRANE; Mob:+355 69 40 98 814 NIPT: M 01308013 C
Str. "Arkitekt Kasemi", Building No.22, “Brryli”, Tiranë; e-mail: ecgroup20@gmail.com



















*Figura 3: Foto nga gjendja ekzistuese*

## 2. QELLIMI I PROJEKTIT

Nepermjet projektit per rehabilitimin e shkarkuesit te rezervuarit Nikel, synohet

- Te behet, rehabilitimi, pastrimi dhe sistemimi i shtratit te shkarkuesit dhe sistemimi i zones perreth tij.
- Te disiplinohen ujerat e prurjeve katastrofike ne liqen.
- Sistemimi i zones, nivelimi i saj me mbushje gure, (detajet ne vizatime).
- Rakordimi i niveleve midis kaperderdhesit, rrymeshpejtuesit dhe pusit te shuarjes se energjise.

## 3. ZGJIDHJA TEKNIKE

### 3.1 Rrymeshpejtuesi

Per realizimin e rehabilitimit te kanalit dhe sistemimit te tij do te kryhen punime germimi, mbushje, betoni (shto ketu trajtimin e elementeve ekzistues) ne shtratin e rrymeshpejtuesit dhe zonen perreth.

Skarpatat e kanalit do te jene sipas detajeve ne vizatimet, per percaktimin e te cilave eshte marre parasysh forma ekzistuese, si dhe gjeologjia e terrenit.




*Figura 4 – seksioni terthor tip 1 rrymeshpejtuesit*




*Figura 5 – seksioni terthor tip 2 rrymeshpejtuesit*

## 3.2 Pusi shuarjes se energjise

Ne fund te rrymeshpejtuesit gjendet pusi i shuarjes se energjise. Ne pjesen fundore te tij, ne anen jug-lindore do te ndertohet nje mure beton arme.




*Figura 6 – Pusi i shuarjes se energjise*




*Figura 7 – Pusi i shuarjes se energjise – Muri i ri*

## 3.3 Vepra



*Figura 8 – Planimetria e pergjithshme e shkarkuesit, kaperderdhesi, rrymeshpejtuesi, pushi i shuarjes se energjise*

## 3.4 Profili gjatesor dhe profilat terthore



*Figura 9 – profili gjatesor i shkarkuesit*










*Figura 10 – profila terthore*